UNIVERSITETI "FEHMI AGANI" I GJAKOVËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË
***PROGRAMI*: GJUHË SHQIPE**

P U N I M I D I P L O M Ë S

***TEMA*: KONGRESI I MANASTIRIT DHE RËNDËSIA E TIJ**

Mentori:

Prof. dr. Ragip Mulaku

Kandidatija:

Blerentina Gashi

Gjakovë, 2018

Ky punim diplome u mbajt më datën……..

Para komisionit vlerësues, i përbërë nga:

_____ kryetar/e

_____anëtar/e

_____anëtar/e

Komisioni vlerësues, e vlerësoi punimin me notë:_____( )

Nënshkrimet e anëtarëve të komisionit vlerësues:

1._____, kryetar/e

2._____, anëtar/e

3. _____, anëtar/e

Përmbajtja

1. ABSTRAKT---------- 4-5

2. PARATHËNIE---------- 6

METODOLOGJIA E PUNËS---------- 7- 8

3. HYRJE----------9-10

4. RRUGËTIMI DREJT FORMIMIT TË ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE --- 11-17

5. KONGRESI I MANASTIRIT - RRUGA DREJT BASHKIMIT KOMBËTAR-- 18-19

6. ZHVILLIMET NË KONGRESIN E MANASTIRIT---------- 20-21

7. VENDIMI PËR ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE---------- 22-24

8. VENDOSJA E ALFABETIT NË KONGRESIN E MANASTIRIT DHE ZHVILLIMET E MËTEJSHME ---------- 25-27

9. PËRFUNDIMI---------- 28-29

10. LITERATURA---------- 30-31

ABSTRAKT

Shqipja, si gjuhë e folur është një ndër gjuhët më të moçme indoevropiane, që përbën një degë më vete në familjen e gjuhëve respektive indoevropiane. Mirëpo, si gjuhë e shkruar, gjuha shqipe është ndër gjuhët më të reja, sepse është e dokumentuar me shkrim shumë vonë, qysh në shekullin XV. Libri i parë i shkruar shqip, që njihet deri më sot, është "Meshari" i Gjon Buzukut (1555). Kjo vepër është shkruar me alfabetin latin, dhe me disa shkronja të kombinuara që nuk i kishte alfabeti latin i asaj kohe. Gjuha jonë, përpara shkrimeve të saj që njihen, pra përpara shekullit XV, nuk dihet të ketë pasur ndonjë alfabet të vetin, sepse na mungojnë të dhënat - dokumentet. Pohimet e gjithë atyre që pretendojnë se shqiptarët, përkatësisht paraardhësit tanë, ilirët, kanë pasur gjoja alfabet të vetin, si dhe disa pohime të tjera që dëgjohen kohët e fundit se ne kemi qenë populli më i vjetër dhe shqipja ka qenë gjuha më e vjetër dhe prej nesh kanë origjinën gjithë popujt e tjerë dhe prej shqipes burojnë të gjitha gjuhët e botës, s'janë gjë tjetër po vetëm iluzione, dhe si të tilla janë jo shkencore dhe të pabazuara në fakte.

Rrugëtimi drejt formimit të alfabetit të gjuhës shqipe, siç dihet, ka qenë i gjatë dhe i vështirë për një varg arsyesh. Kështu, që nga themelimi i shtetit shqiptar i epokës së ndritshme të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, që u arrit nëpërmjet përbashkimit të principatave shqiptare në një të vetme sipas Kuvendit të Arbërit në Lezhë, populli ynë, me pushtimin turk, vetëm pas pesë shekujsh, pra më 1912 arriti të bëhej shtet i pavarur në një territor të cunguar. Gjatë asaj periudhe pesëqind vjeçare, gjuha shqipe pati në përdorim në shkrimin e saj tri alfabete kryesore: alfabetin latin, atë grek, alfabetin turko-arab, si dhe një varg alfabete.

Sipas programit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që u formulua në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878) kërkohej ruajtja dhe mbrojtja e tokave shqiptare, zgjidhja e çështjes së alfabetit të shqipes, botimi i librave shqip dhe hapja e shkollave në gjuhën amtare, ngritja e vetëdijes kombëtare dhe njësimi i gjuhës letrare shqipe në një formë të vetme të përbashkët për të gjithë shqiptarët, që do të përdorej në administratë, në arsim, në mjetet e informimit dhe në të gjitha institucionet shtetërore. Nga të gjitha këto detyra të ngutshme që u shtruan për t'u përmbushur, e para dhe më e ngutshmja që nisi së realizuari qe hapja e shkollave në gjuhën shqipe, prandaj u çel shkolla e parë shqipe në Korçë (1887), si dhe botimi i librave në gjuhën shqipe dhe zhvillimi i arsimimit të popullit në gjuhën shqipe dhe zhdukja e analfabetizmit. Në këto rrethana u vu re se duhej të zgjidhej çështja e alfabetit të shqipes për arsye se përdorimi i shumë alfabeteve pengonte dhe vështirësonte përhapjen e dijes në masat e gjera popullore shqiptare. Së këndejmi, e para detyrë madhore, kulturore e politike që u zgjidh ka qenë alfabeti i gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit (1908). Alfabeti i gjuhës shqipe, që u vendos në Kongresin e Manastirit ishte i bazuar në shkronjat latine perëndimore. Në Kongresin e Manastirit u shtruan për t'u zgjidhur edhe probleme të tjera kulturore dhe politike. Pas zgjidhjes se problemit te alfabetit dhe miratimit të tij u hap kështu rruga edhe për zgjidhjen e problemeve të tjera të kulturës shqiptare. Aty u kërkua që pas një viti të mbahej një kongres tjetër, mundësisht në Janinë, ku do të zgjidhej edhe njësimi i gjuhës shqipe. Siç dihet, njësimi i gjuhës letrare shqipe u mbeti brezave të mëvonshëm për arsye se realizimi i këtij problemi kërkonte kohë dhe përkushtim shumë më të madh të inteligjencies shqiptare.

FJALËT ÇELËSE: *zanafilla, gjuha dhe letërsia shqipe, veprimtaria kombëtare, norma, klube qendrore, shkolla shqipe, tematika, biblioteka*.

PARATHËNIA

Dihet se zhvillimet dhe risitë në sistemin gramatikor të një gjuhe në përgjithësi janë të ngadalshme e deri diku të pa vërejtshme, në krahasim, p.sh., me sistemin leksikor, që vihen re që në shikim të parë. Kësaj rregulle i nënshtrohet edhe gjuha jonë - shqipja. Nisur nga kjo pikëpamje, zhvillimet dhe risitë në sistemin gramatikor të shqipes në këta katër shekuj e gjysmë të shkrimit të saj (që nga koha e Gjon Buzukut -1555) nuk janë aq të mëdha. Por brenda sistemit të përgjithshëm gramatikor të shqipes është pikërisht sistemi foljor ai që karakterizohet nga zhvillimet më të dukshme dhe nga dallimet më të mëdha ndërmjet të folmeve e dialekteve të gjuhës sonë.

Nëpërmjet këtij punimi të diplomës synojmë që në tërësi ta trajtojë rëndësinë e Kongresit të Manastirit, duke filluar që nga përgatitjet e tij, mbajtja e Kongresit, pjesëmarrja e delegatëve aty dhe përfaqësimi i tyre në mbledhje, miratimi i alfabetit, si dhe zhvillimet e mëtejshme i alfabetit dhe mbizotërimi i njërit variant ndaj variantit tjetër etj., do të jenë çështje e kësaj teme. Punimi i kësaj teme mendoj se është e një rëndësie të veçantë, pasi që shtjellon zgjidhjen që i është bërë problemit të alfabetit të shqipes, pra të një çështjeje që ka pasur peshë të veçantë për kulturën e gjuhës në veçanti dhe për gjuhën shqipe në përgjithësi.

METODOLOGJIA E PUNËS

Për të shtjelluar këtë punim diplome kam përdorur literaturë përkatëse, veprat e vështrimet e autorëve të ndryshëm, dhe po ashtu jam konsultuar disa herë me mentorin tim. Jam munduar të nxjerr karakterin e temës dhe gjithë punën krijuese që tema të dalë sa më e suksesshme.

Gjatë viteve të studimeve në Fakultetin Filologjikë në Gjakovë dega Gjuhë shqipe, dhe pasi kam marrë njohuri mësimore e krijuese nga një staf i përgatitur akademik i jam përkushtuar që ta punoja këtë temë të diplomë.

Duke u konsultuar me mentorin tim dhe me mësimdhënësit e mi të nderuar, ne vendosëm që punimin e diplomës ta bëjmë në fushën e Gjuhësisë.

Pasi bashkërenduam çështjen e temës, u përcaktova që të merrem me fushën e gjuhës së sotme shqipe, duke u përqendruar në shqyrtimin dhe vlerësimin e punimeve të Kongresit të Manastirit, të cilat kishin të bënin me njërin ndër problemet me rëndësi të veçantë të kulturës sonë dhe që lidhet ngushtë fund e krye me zgjidhjen e alfabetit të gjuhës shqipe.

Në shtjellimin e kësaj teme kam zbatuar (përdorur) këtë metodologji pune:

- Hulumtimi i literaturës përkatëse në gjuhën shqipet të lidhur me alfabetin e shqipes;
- Mbledhja e të dhënave për temën në fjalë;
- Konsultimi me kolegë dhe me njohës të gjuhës dhe të kulturës sonë, që merren me edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj;
- Analistët që janë marrë me këtë problematikë.

Marrë në përgjithësi, punimi do të ketë një rrjedhë kronologjike të ngjarjeve në këtë kontekst, nga ato që i kanë paraprirë atij,e deri tek ato që vijnë pas tij.

HYRJE

Në këtë punim bëhet fjalë për një çështje mjaft të rëndësishme të kulturës së popullit shqiptar, për rrugëtimin e alfabetit të shkrimit të shqipe, që ka kaluar nëpër një proces mjaft të vështirë, varësisht nga rrethanat politike dhe problemet e tjera që e kanë shoqëruar në përputhje edhe me zhvillimin e gjuhës shqipe në të kaluarën historike të popullit shqiptar. Zhvillimi i gjuhës shqipe që nga dokumentet e para të saj me botimin e veprave të vjetra që njihen në gjuhën shqipe nga autorët tanë të shekujve XV - XVIII, pastaj botimi i abetares se parë, botimi i revistave në klube të ndryshme shqiptare, hapja e shkollës se parë shqipe dhe e shkollave të tjera në gjuhën shqipe, zgjidhja e problemit të alfabetit të gjuhës sonë në Kongresin e Manastirit, i cili e hapi rrugën e një zhvillimi më të hovshëm të arsimimit të popullit tonë dhe të përhapjes së dijes në masat e gjera shqiptare, si dhe në mbajtjen e Komisisë Letrare të Shkodrës (1916/17), pastaj në Konsultën e Prishtinës të vitit 1968, që u kurorëzua me Kongresin e Drejtshkrimit (1972), ku u zgjidh edhe njësimi i gjuhës letrare shqipe.

Pra në këtë punim bëhet fjalë në radhë të parë për zgjidhjen e alfabetit të gjuhës shqipe në .Kongresin e Manastirit , i cili u mbajt në atë qytet historik më 14 nëntor të vitit 1908, ku morën pjesë një numër i madh delegatësh dhe përfaqësuesish të qyteteve të ndryshme shqiptare, për vendosjen e alfabetit të gjuhës shqipe, të një alfabeti të vetëm, të përbashkët për shkrimin e shqipes, i cili me të drejtë u quajt edhe dita e alfabetit.

Kështu, gjatë mbarështrimit të këtij punimi, do të vihet në pah:

- Rrugëtimi i formimit të alfabetit të gjuhës shqipe
- .Ecuria e përgatitjes së Kongresit të Manastirit
- Kongresi i Manastirit, rruga drejtë bashkimit kombëtar
- Rrethanat kulturo-historike ekzistuese të asaj kohe
- Delegatët pjesëmarrës
- Vendimet e marra në Kongresin e Manastirit si dhe arsyet e pranimit të këtyre vendimeve.

RRUGËTIMI DREJT FORMIMIT TË ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE

Shkrimet e para në gjuhën shqipe, si ato me karakter fetar, përkthimet biblike, si dhe veprat letrare të gjuhës shqipe, etj., para mbajtjes së Kongresit të Manastirit etj., që nga dokumentet e para e deri në njësimin e alfabetit të shqipes nuk shkruheshin në një alfabet të vetëm, por në alfabete të ndryshme. Dokumentet e para, Formula e pagëzimit (1462) dhe Fjalorthi i Arnold von Harfit (1497) janë shkruar me alfabetin latin. Me këtë alfabet janë shkruar edhe "Meshari" i Gjon Buzukut (1555), vepra e parë e njohur në gjuhën shqipe, vepra e arbëreshit Lekë Matrëngës "E mbësuame e kërshterë" (1492), pastaj tri veprat e Pjetër Budit, Fjalori latinisht – shqip i Frang Bardhit (1635), vepra e Pjetër Bogdanit "Çeta e profetëve" (1685), Gramatika e Da Leçes (1706), veprat e rilindësve shqiptarë etj. Me alfabetin grek është shkruar Perikopeja e Ungjillit e Shën Matheut, e fillimit; me alfabetin grek kanë shkruar edhe voskopojarët Theodor Haxhifilipi (1760), Dhaniel Haxiu (1802), Konstantin Berati (1767) etj.; me alfabetin turko-arab kanë shkruar bejte4xhinjtë: Nezim Frakulla, Sulejman Naipi, Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Çami- Kyqyku, etj.[1]

Siç mund të shihet, alfabeti më i vjetër dhe më i përhapur në shkrimin e shqipes ka qenë alfabeti latin, i cili ka pasur një traditë përdorimi dhe është përdorur pandërprerë në shkrimin e veprave më të njohura të gjuhës shqipe derisa është sanksionuar edhe në Kongresin e Manastirit si më i përdorshmi dhe më i

[1] Mahir Domi, *Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, në përmbledhjen e punimeve me po atë titull, Tiranë, 1972, f. 10.

pëlqyeshmi. Alfabeti i dytë për nga mosha në shkrimin e shqipes ka qenë alfabeti greko-ortodoks, i cili ka pasur edhe prapavijë politike, pra një ndikim nga patrikana greke mbi shqiptarët e jugut. Alfabeti i tretë në shkrimin e shqipes ka qenë ai turko-arab i përdorur nga shkrimtarët bejtexhinj të shekullit XVIII në një territor të kufizuar shqiptar. Një tjetër veçori e shëmtuar e shkrimeve të hartuara me këtë alfabet ka qenë vërshimi a përmbytja e tyre me fjalë turke e arabe.

Përveç këtyre tri alfabeteve, që kanë qenë të njohura në shkrimin e shqipes, janë përdorur edhe disa alfabete të veçanta, të cilat kanë pasur shtrirje në rrethe tepër të kufizuara, siç ka qenë alfabeti që është përdorur në shkrimin e Anonimit të Elbasanit, i përbërë prej 40 grafemash; alfabeti i Jan Vellarit, pastaj ai i Dhaskal Todrit me 52 germa etj.[2]

Çështja e alfabetit të përbashkët të shqipes u bë preokupim i intelektualëve të shek XIX, pra atëherë kur atdhetarët tanë më të flaktë këtë çështje e vunë në qendër të vëmendjes së tyre[3]. Ishte koha kur te të gjithë popujt e Ballkanit ishte zgjuar ndjenja kombëtare për t'u çliruar nga zgjedha turke. Dashuria që ushqenin ndaj vlerave kombëtare, e në mënyrë të veçantë ndaj gjuhës, arsimit dhe kulturës kombëtare, si elemente dalluese të një kombi, zgjoi tek atdhetarët tanë të asaj kohe interesimin e tyre për të zgjidhur problemin e alfabetit për shkrimin e librave nëpërmjet së cilave do të përhapnin dijen dhe kulturën në mbarë vendin. Në punë të gjuhës sonë dhe në mënyrë të veçantë në problemin e alfabetit të saj, intelektualët e Rilindjen Kombëtare Shqiptare vazhduan të ecnin rrugës së trashuar shekuj me radhë, duke mbajtur anën e Evropës së qytetëruar Perëndimore, pra duke e përqafuar alfabetin latin "i cili plotësonte më së miri kërkesat fonetike të

[2] M. Domi, *vep. cit*. f. 14.
[3] Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999, f. 4.

gjuhës shqipe dhe grafikisht ishte më i përshtatshëm”[4]. Në këtë mënyrë mendimi që mbizotëroi në zgjidhjen e alfabetit të gjuhës sonë në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare ka qenë të gjendet një alfabet me shkronja latine. Ky parim u përqafua dhe u ndoq nga të gjithë intelektualët tanë të asaj periudhe të ndritshme kombëtare. Së këndejmi, nuk ishte gjë e rastit orientimi i rilindësve tanë kah perëndimi në lidhje me përzgjedhjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Interesimi i tyre për të zgjidhur problemin e alfabetit të gjuhës shqipe arriti kulmin sidomos në gjysmën e parë të shekullit XX. Nismëtar i rilindësve në këtë çështje ishte dorëmbari Naum Veqilharxhi me Evëtarin dhe me alfabetin me bazë latine që krijoi për shkrimin e shqipes. Punën e nisur prej tij e vazhduan, e përsosën dhe e thelluan një plejadë e tërë atdhetarësh, si: Konstantin Kristoforidhi, Pashko Vasa (me moton e tij: “*t’i lëmë kisha e xhamia se feja shqiptare është shqiptaria”*), Hoxha Tahsini, Jani Vreto, Sami Frashëri, De Rada, Dhimitër Kamarda e shumë të tjerë, të cilët qysh në vitin 1879, të cilët e hartuan alfabetin e Stambollit me bazë latine, sipas të cilit çdo tingull i sistemit fonetik të shqipes duhej të përfaqësohej me një grafemë të vetme, pra me një shenjë gjuhësore. Për këtë arsye, shoqëria më aktive dhe e mirënjohur "Bashkimi" në Manastir, thirri Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njësuar. Një alfabet i njësuar do të ishte edhe fillimi i njësimit të letërsisë mbarë shqiptare. Në këtë hulli, më 14 nëntor 1908 në Manastir u mblodh Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit.

Në Kongres ishin të pranishëm 160 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit'hat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit. Mit'hat Frashëri ishte në atë kohë redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik: Liria dhe Dituria. Sekretare e komisionit u zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e

[4] T. Osmani, *vep. cit,* f. 5.

shkollës së vashave në Korçë. Nënkryetar u zgjodh Grigor Cilka, nga Korça si dhe 11 anëtarë të tjerë. Në atë Kongres merrnin pjesë shqiptarë te fesë myslimanë, katolike, ortodoksë, dhe protestantë, njerëz të ditur dhe që të gjithë erdhën dhe u bashkuan, për arritjen e një qëllimi të madh kombëtar.

. Kërkesat e atdhetarëve shqiptarë në Kongres ishte që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por me germa latine, gjë që do nënkuptonte mos orientimin, qoftë ndaj otomanëve as ndaj grekëve. Kongresi vendosi me votë unanime të lërë në përdorim alfabetin e Stambollit, dhe alfabetin latin me 36 shkronja i cili përdoret edhe në ditët tona. Gjithashtu, u vendos që pas dy vjetësh të mbahej një Kongres i dytë në Janinë për të shqyrtuar problemet drejtshkrimore e letrare, si dhe për të bërë përpjekje për shkrirjen e dialekteve të gegërishtes dhe toskërishtes në një gjuhë të njësuar shqipe. Duke qenë se para Kongresit të Manastirit, gjuha shqipe ishte shkruar me shkronja arabe, greke, sllave, apo përshtatjet e tyre, vendosmëria e delegatëve për t'i kthyer sytë nga perëndimi ishte haptazi një orientim kulturor drejt perëndimit ky orientim u vu re nga qeveria turke si dhe nga kisha ortodokse greke dhe aleatët e tyre sllavë. Në Manastir u hap dhe shtypshkronja, e cila financohej nga një grup tregtarësh atdhetarë myslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në të gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Në këtë shoqatë ishin të punësuar 17 veta të cilët kishin punuar me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme Bashkimi i Kombit si dhe abetaret shqipe dhe tekstet shkollore.

"Zgjidhja fatlume e alfabetit të shqipes tash e njëqind vjet më parë ia hapi pastaj rrugën edhe çështjeve të tjera me rëndësi kulturore e kombëtare, dhe veçanërisht përafrimit të të dy varianteve dialektore të shkrimit të shqipes në një

formë të vetme për të gjithë shqipfolësit, në në gjuhën standarde që përdorim që nga Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) dhe sidomos që nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1872”[5].

Vendimet e Kongresit të Manastirit hapën rrugën edhe për masivizimin e shkollës kombëtare shqipe dhe për zhvillimin e shqipes së shkruar, e cila mori orientimin drejt standardizimit dhe pasurimit të saj në vitet dhe në dhjetëvjetëshat që erdhën[6].

Caktimi i alfabetit latin i Stambollit në shkrimin e shqipes shënoi një hap të rëndësishëm përpara për lëvizjen kulturore. Ai ishte alfabeti i parë i pranuar nga shumica që u mirëprit nga rrethet patriotike brenda dhe jashtë atdheut dhe pati përhapje të gjerë në të gjitha trojet shqiptare dhe në të gjitha shkollat shqipe. Meqenëse ky alfabet ishte i përzier edhe me shkronja jolatine, nuk ishte shumë praktik, prandaj, krahas tij, u përdorën edhe alfabete të tjera dhe çështja e alfabetit të përbashkët u diskutua përsëri më vonë. Nuk kaluan as dy-tre muaj pas caktimit të alfabetit të Stambollit, me të u botua në Stamboll *“Abetarja e gjuhës Shqipe”*. Më 12 tetor 1879 Konferenca vendosi themelimin e shoqërisë kulturore dhe miratoi statutin të cilët e nënshkruan të gjithë pjesëmarrësit. Alfabetarja u përhap kudo brenda dhe jashtë atdheut dhe shërbeu për të mësuar shkrim-leximin e shqipes dhe për të përhapur idetë kombëtare e demokratike të Rilindjes.

Hapja e shkollave dhe e mësim-shkrimit shqip, si dhe sukseset, që arritën patriotët shqiptarë në përpjekjet e tyre për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar, bënë edhe më të ngutshme nevojën e vendosjes së një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Nismën për thirrjen e Kongresit kombëtar për vendosjen e një alfabeti të vetëm e mori klubi shqiptar “Bashkimi” i Manastirit, që luante rolin

[5] Ragip Mulaku, *Ndihmesa për gjuhën shqipe* ,Prishtinë , 2015, f. 54.
[6] Isa Bajçinca, Shqipja standarde dhe probleme rreth saj, Prishtinë, 2016, f. 303.

kryesor midis klubeve shqiptare. Qysh në atë kohë drejtuesit e klubit *"Bashkimi"* të Manastirit, duke kuptuar rëndësinë e madhe që kishte zgjidhja e alfabetit, formuan 66 klube dhe mbajtën 4 Kongrese Kombëtare, dhe hapën 24 shkolla fillore. Që në ditën e parë shkolla në Elbasan regjistroi 1500 nxënës. Më 27 gusht të vitit 1908, pas vendimit që kishte marrë që më 21 gusht, kryesia e klubit *"Bashkimi"* të Manastirit, ftoi të që të dërgonin përfaqësuesit e tyre të gjitha klubet dhe shoqëritë brenda dhe jashtë Shqipërisë për mbledhjen e kongresit të alfabetit më 14 nëntor të vitit 1907, në të cilin "do të ftoheshin të gjithë Shqiptarët, gegë e toskë, si dhe përfaqësuesit e klubeve jashtë atdheut, u interesonte kjo çështje, dëshironin të merrnin pjesë në këtë kongres të madh të alfabetit të shqipes.[7]

Nisma e klubit *"Bashkimi"* të Manastirit për thirrjen e Kongresit të alfabetit u prit me gëzim nga klubet dhe gjithë atdhetarët shqiptarë dhe gjeti përkrahjen e tyre të plotë.[8]

Konsulli austro-hungarez në Shkodër, shkruante në fillim të nëntorit se njoftimi për këtë kongres "pati jehonë të madhe".[9] Në letrat, që i erdhën klubit *"Bashkimi"* të Manastirit nga klubet dhe shoqëritë Shqiptare, si nga ai i Elbasanit, i Janinës, i Shkupit, i Shkodrës, i Beratit, i Starovës,i Ohrit, pastaj nga kolonitë shqiptare të Kajros, të Aleksandrisë, të Bukureshtit, të Varnës, nga shoqëria *"Besa-besën"* dhe nga dhjetëra klube, shoqëri dhe atdhetarë shqiptarë brenda dhe jashtë Atdheut, shprehej entuziazmi i tyre për thirrjen e kongresit dhe gatishmëria për të dërguar përfaqësuesit e tyre në këtë kongres.[10] Alfabetin latin, siç mund të pritej, e përkrahën më shumë shqiptarët jashtë atdheut, të cilët, për shkak të njohjes së gjuhëve evropiane të mbështetura në këtë alfabet i njihnin më mirë epërsitë e tij.

---

[7] Shukri Rrahimi, *Gjurmime Historike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Prishtinë, 1986, f. 76.
[8] Shaban Demiraj – Kristaq Prifti, *vep. cit.*, f. 46.
[9] Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar II*, f. 212.
[10] P. Bartol, *vep. cit.*, f. 125.

Më të paktë ishin përkrahësit e alfabetit të Stambollit, dhe pse ai kishte marrë një përhapje të gjerë në Shqipërinë e Jugut.

Me rëndësi të veçantë është fakti që nismën për thirrjen e Kongresit të Alfabetit e përkrahu edhe shoqëria *"Bashkimi"* e Shkodrës, e cila në një ftesë, që publikoi qysh më 20 gusht 1908, theksonte se "kjo shoqëri kishte pranuar që 10 vjet më parë alfabetin latinë si më i lehti për t'u mësuar, të cilin e përdor e gjithë bota perëndimore.[11]

Kongresi u mbajt në Manastir prej 14 nëntor 1908 dhe i vijoi punimet deri më 22 nëntor të atij viti. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Kongresi i Manastirit u shndërrua kështu në një kuvend të vërtetë mbarë shqiptar, në të cilin morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Manastirit, të Kosovës, të Janinës e të Shkodrës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të SHBA-së, të Egjiptit, të Italisë etj.

[11] Sh. Demiraj - K. Prifti, *vep. cit.*, f. 50.

KONGRESI I MANASTIRIT – RRUGA DREJT BASHKIMIT KOMBËTAR

Veprimtaria kombëtare, ose më konkretisht, ajo kulturo-arsimore dhe gjithë proceset që shkojnë në favor të çështjes kombëtare kanë pasur momente kur janë lartësuar, kanë qenë të çmuara dhe të domosdoshme për kohën dhe rrethanat ku edhe ishin të krijuara ose të inicuara, dhe, ka pasur edhe momente kur kanë pasur rënie, rënie jo nga vetë koha, por zhdukje me qëllim për të humbur ose ndaluar realizimin e idealeve. Në periudhën para 1908, atdhetarët tanë kanë punuar në kushte të vështira, sidomos intelektualët që merreshin me aktivitete letrare ose kulturore. Duke marrë parasysh se territori shqiptar ka qenë i ndarë në 4 vilajete: i Kosovës, i Shkodrës, i Janinës dhe i Manastirit, secili vilajet ka pasur nga një ose më shumë figura me të cilët ne sot mburremi dhe do të mburremi edhe më tepër sikur ta dimë saktësisht mbarë veprimtarinë e tyre të asaj kohe.

Dua të them, që të gjithë në një mënyrë a në një tjetër kanë punuar duke iu përshtatur kushteve dhe rrethanave të kohës. Atdhetarët e Shkodrës e përdornin alfabetin e *"Agimit",* gjithashtu edhe ata të Kosovës ose gegët me një fjalë shërbeheshin me alfabetin e lartpërmendur. Toskët ose banorët e dy vilajeteve të tjera, shërbeheshin me atë latin ose me atë të Samiut ose të "Stambollit". Në fillim kishte vështirësi për botuesit e librave, sepse nuk ishte punë e lehtë për t'u gjetur shtypshkronjë të pajisur me këto germa, përveç ajo e alfabetit latin, për të cilin alfabet ka pasur shtypshkronja në tërë Evropën.

Dallimi që ka ekzistuar ndërmjet alfabeteve të ndryshme dhe vështirësitë që kanë shkaktuar përdorimi i disa alfabeteve në përhapjen e arsimit e të kulturës dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare, bëri që të merrej vendim për krijimin e një

alfabeti të përbashkët, një për të gjithë dhe i pranueshëm nga të gjithë. Fjala vjen, kur erdhi momenti që të tre alfabetet të bashkohen në një, sepse, sipas vendimeve të Kongresit, duhej që të formohej një alfabet me një kombinim grafemash latine.

Me vetë themelimin të Alfabetit të Manastirit, shqiptarët treguan se janë popull i civilizuar, që po i afroheshin botës së qytetërimit, me një alfabet të njësuar në shërbim të zhvillimit të gjuhës dhe letërsisë mbarë shqiptare.

Meritat më të mëdha për bashkimin të tre alfabeteve pa tjetër që i ka pasur dhe i ka klubi "Bashkimi", por ai që e shtyre përpara këtë çështje ka qenë Gjergj Fishta. Kjo vërehet kur ai paraqitet në foltore dhe drejtohet para të gjithëve me fjalët: "S'kam ardhur që të mbroj asnjë alfabet, por, të mbroj një alfabet të përbashkët".

Kongresi i Manastirit, me atë që bëri, duke përzgjedhur një alfabet të ri e të vetëm, pra alfabetin latin, jo vetëm që u mundësoi shqiptarëve të kenë një alfabet të përbashkët, por njëkohësisht u zgjidh njëherë e mirë kjo çështje kulturore, duke marrë shqiptarët drejtimin e popujve perëndimor dhe duke shmangur ndikimin ortodoks të kishës bizantine greke, si dhe ndikimin e lindjes e të orientit: një komb, një gjuhë, një abece, abece manastirase, e cila ndriti historinë e popullit tonë. Ne na mbetet vetëm që të bëjmë edhe akt tjetër, aktin e bashkimit kombëtar, të cilin rilindësit tanë të bekuar e kanë pasur ideal, por nuk arritën ta realizonin.

KONGRESI I MANASTIRIT

Me vendimin e Kongresit të Manastirit ka qenë ngritur në oborrin e familjes së Parashqevi Qiriazit një Shtypshkronjë Universale Shqiptare. Nga ajo shtypshkronjë dolën 300 tituj të shkrimeve, librave, abetareve dhe publikimeve të ndryshme shkencore etj., në 13 gjuhë të botës, të cilat bënë jehonë në të katër anët e rruzullit tokësor, gjë që çështja shqiptare u afirmua dhe u hap dhe rruga drejt Pavarësisë së Shqipërisë. Pikërisht këtu qëndron roli i familjes Qiriazi dhe i Kongresit të Alfabetit, në të cilin, siç thashë, u mor vendimi për ngritjen e institucionit në fjalë. Përndryshe, Kongresi i Manastirit ishte urë midis Lidhjes së Prizrenit dhe Pavarësisë së Shqipërisë. Sepse, në Lidhjen e Prizrenit të vitit 1878 u aktualizua nevoja e krijimit të Alfabetit të përbashkët. Prandaj, jo rastësisht, vetëm disa muaj pas kësaj, gjegjësisht gjatë vitit 1879, u krijua Alfabeti i Stambollit, i njohur edhe si Alfabeti i Sami Frashërit, sepse ky me duart e veta i krijoi gërmat e atij Alfabeti, i cili u vlerësua lart në Kongresin e Manastirit.

Ndërkaq, lidhja e Kongresit me Pavarësinë e Shqipërisë qëndron në faktin që para këtij Kongresi, shqiptarët përdornin alfabete të ndryshme, të cilat, jo vetëm që pengonin komunikimin normal midis tyre, përmes letrave, por shkaktonin edhe grindje, sepse bihej nën ndikim të vendeve nga të cilat rridhte alfabeti. Në Kongresin e Manastirit "për të parën herë në historinë e lëvizjes kombëtare, u përfaqësuan aty të gjitha organizatat patriotike shqiptare. Kongresi u dha mundësinë delegatëve të ardhur nga krahina të ndryshme të vendit dhe nga kolonitë jashtë atdheut, t'i shqyrtonin së bashku çështjet e përgjithshme të zhvillimit politik, ekonomik e kulturor të Shqipërisë si dhe çështjet e bashkimit të të gjithë shqiptarëve"[12]. Me aprovimin e Alfabetit të Manastirit, pengesat në fjalë si dhe grindjet u shuan dhe kështu u ndoq rruga që kishin trasuar veprimtarët e Lidhjes së Prizrenit drejt Pavarësisë së Shqipërisë, e cila u realizua pikërisht pas 4 viteve nga Kongresi i Manastirit, pra më 28 nëntor 1912.

[12] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar, II*, Prishtinë, 1979, f. 286.

VENDIMET PËR ALFABETIN E GJUHËS SHQIPE

Çështjet kryesore, që u bënë objekt diskutimi në Kongres kanë qenë këto:

1. Duhej njohur si alfabet i vetëm i shqipes njëri nga të tre alfabetet më të përhapura (i Bashkimit, Agimit dhe Stambollit),

2. Duhej të shqyrtoheshin të tre alfabetet dhe prej tyre të hartohej një alfabet i ri, dhe

3. Duhej të krijohej një alfabet i ri i shqipes, i përkrahur prej të gjithë delegatëve.

Në këtë Kongres ishin të pranishëm 50 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare të Rumanisë, Italisë, Greqisë, Turqisë, Egjiptit, të Amerikës etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri (1880-1949), i biri i Abdyl Frashërit.

Mithat Frashëri ishte në atë kohë redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik: "Liria" dhe "Dituria". Sekretare e komisionit u zgjodh Parashqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë. Nënkryetar u zgjodh Grigori Cilka, nga Korça, si dhe 11 anëtarë të tjerë.

Në Kongres morën pjesë shqiptarë te fesë myslimane, katolike, ortodokse, protestane, njerëz të ditur dhe që të gjithë erdhën së bashku për arritjen e një qëllimi me peshë të madhe kombëtare. Pra, detyra e parë që duhej zgjidhur, ishte njësimi i alfabetit. Deri atëherë shqipja ishte shkruar në disa alfabete: në alfabeti latin, grek dhe në alfabetin turko-arab, si dhe në disa alfabete të veçanta, që kishin

shtrirje më të kufizuara. Vendin kryesor në punimet e Kongresit, duke përfshirë edhe mbledhjet e hapura, e zuri çështja e caktimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët.

Gjatë diskutimeve që u bënë në ditët e para, të gjithë shfaqën mendimin se alfabeti që do të vendosej duhej të kishte për bazë atë latin. Por pikëpamjet e delegatëve më tej u ndanë, në ditën e tretë të punimeve. Kështu, Kongresi zgjodhi një komision prej 11 vetash, të kryesuar nga at Gjergj Fishta, ku bënin pjesë njohësit më të mirë të gjuhës shqipe, përkrahës të alfabeteve të Stambollit , të *"Bashkimit"* dhe të *"Agimit"* si dhe intelektualë të tjerë të shquar.

Komisionit iu besua e drejta e plotë për të vendosur për këtë çështje. Duke pasur parasysh zgjidhjen e një problemi kaq të rëndësishëm e me vlerë të përhershme kulturore për mbarë kombin tonë, anëtarët e Komisionit, pas shumë e shumë diskutimesh vendosën që të mos merrej për bazë asnjëri nga tri alfabetet ekzistuese, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e atij latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Me gjithë vendimin e drejtë e të arsyeshëm që u mor, Komisioni ndeshi në vështirësi jo të lehta për gjetjen e grafemave dyshe që duhej të pasqyronin disa tinguj të veçantë e specifikë të shqipes, siç janë: *dh, gj, xh, sh, nj, th,* që i mungonin alfabetit latin. Në këto rrethana pas tri ditë diskutimesh (17-19 nëntor), anëtarët e komisionit, sikurse thuhej në vendimin e Kongresit,"të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme", nuk arritën të caktonin një alfabet të vetëm për gjuhën shqipe, prandaj vendosën "të ktheheshin prapa", duke pranuar alfabetin e Stambollit, sipas të cilit çdo tingull të përfaqësohej me një shkronjë "e me të bashkë edhe një abc thjesht latine, që të përdoreshin e të mësoheshin bashkërisht në mes të shqiptarëve".

Të dy alfabetet (me dallime jo të mëdha) do të përdoreshin detyrimisht në shkolla. Ky vendim që vetëm Kongresi e quajti kthim prapa, u argumentua nga

Komisioni me "disa shkaqe të përjashtme" edhe pikërisht me nevojën për të shtypur me alfabetin thjesht latin libra jashtë Shqipërisë dhe për korrespodencat me jashtë. Në të vërtetë, me shkaqe të jashtme nuk kuptoheshin vetëm ato thjesht teknike, por edhe trysnia e ushtruar mbi Komisionin nga qarqet e shoqëritë e ndryshe shqiptare që ishin për Alfabetin e Stambollit dhe atë të *"Bashkimit"*.

Vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabete është marrë për të mos shkaktuar përçarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Në të njëjtën kohë ai u quajt si një zgjidhje e përkohshme për të kaluar në të ardhmen në përdorimin e një alfabetit të përbashkët të shqipes dhe ushtroi një ndikim të fuqishëm në bashkimin politik dhe përparimin e mëtejshëm kulturor të kombit shqiptar. Me këtë vendim iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes.[13]

[13]Rexhep Qosja, *Semantik e ndryshimeve historike letrare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009),f. 110 -119.

VENDOSJA E ALFABETIT NË KONGRESIN E MANASTIRIT DHE ZHVILLIMET E MËTEJSHME

- Alfabeti i miratuar në atë Kongres u përgjigjej më së miri veçantive të gjuhës shqipe
- Ky ishte alfabet i thjeshtë fonetik
- Nga ky alfabet mënjanohen shkronjat e panevojshme parazitare.
- Gjatë përdorimit ishte më racional.

Përveç kësaj, duke vendosur për këtë variant që mbështetej në atë Latin, Kongresi i Manastirit ripohoi edhe njëherë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar, kundër përpjekjeve të xhonturqve për t"u importuar alfabetin arab dhe për t'i identifikuar ata me turqit. Alfabeti i thjesht latin, duke qenë më homogjen nga karakteri i shkronjave, u tregua më i lehtë e më praktik për t'u përhapur gjithnjë e më shume dhe nga fundi i Luftës së Parë Botërore u bë tashmë alfabeti i përbashkët e i njësishëm për gjithë shqiptarët, pra alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe.[14]

Në gusht të vitit 1908, shoqëria *"Bashkimi"* shpërndau një deklaratë, ku shënonte veprat që kishte botuar gjatë periudhës së ekzistencës prej 10 vjetësh, duke vënë në dukje edhe përparësitë e alfabetit të saj. Me këtë donte t'i tregonte opinionit të kohës vlerat e kësaj shoqërie, veçanërisht në fushë të alfabetit. Edhe në parathënie e këtij fjalori flitet për përparësitë e përdorimit të këtij alfabeti në të ardhmen për të shkruar gjuhën shqipe. E njohur për aktivitetin patriotik, shoqëria

[14] R. Qosja, *vep. cit.* , f. 42 (*Gjergj Fishta dhe prezentimi i Fjalorit të Shoqërisë "Bashkimit"*).

“Bashkimi”, mori pjesë në Kongresin e Manastirit e përfaqësuar me Atë Gjergj Fishtën dhe Luigj Gurakuqin.

Fishta luajti një rol të veçantë dhe u zgjodh kryetar i komisionit të hartimit të alfabetit të shqipes. Delegatët e ngarkuan me një detyrë të tillë për erudicionin e thellë, kulturën e gjerë, performancën e fjalës, mendjen e mprehtë dhe logjikën e fortë. Poeti ynë tashmë kishte bërë emër jo vetëm në veri, por edhe në jug të Shqipërisë. Edhe sistemi shkrimor i kësaj shoqërie pati ndikim në zgjidhjen përfundimtare të alfabetit që u miratua në Kongresin e Manastirit. Kështu, alfabeti i sotëm u udhëhoq nga parimi i zbatuar në alfabetin e shoqërisë *“Bashkimi”,* i përfaqësuar nga At Gjergj Fishta, në përdorimin e dyshkronjëshave, që patjetër ka luajtur rol vendimtar.

Shoqëria *“Bashkimi”* me punën dhe botimet që kreu, i dha një nxitje lëvrimit të gjuhës shqipe dhe zhvillimit të letërsisë dhe teknologjisë shqiptare. Po ashtu Kongresi vendosi më vote unanime të linte mënjanë alfabetin e Stambollit dhe t’i hapte rrugë alfabetit të *Bashkimit*.

Gjithashtu, ishte vendosur që pas dy vitesh të mbahej një Kongres i dytë në Janinë për të shqyrtuar problemet drejtshkrimore e letrare, si dhe për të bërë përpjekje për shkrirjen e dialekteve gegë dhe toskë në një gjuhë të njësuar shqipe. Duke qenë se para Kongresit të Manastirit gjuha shqipe ishte e shkruar me shkronja arabe greke, sllave apo përshtatjet e tyre, vendosmëria e delegatëve për t’i kthyer sytë nga perëndimi ishte haptazi një orientim drejt pavarësisë së vendit, gjë që nuk kaloi pa u vënë re as nga qeveria turke e as nga kisha ortodokse greke dhe aleatët e tyre sllavë.[15]

[15] Edwin Jack, *Shqiptarët, Kartë e pendë*, Tiranë, 1995, f. 456.

Në Manastir u hap dhe shtypshkronja, e cila financohej nga një grup tregtarësh atdhetarë myslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe e gazetave në gjuhën shqipe. Në këtë punishte ishin të punësuar 17 vetë, të cilët punonin me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme *"Bashkimi i Kombit"* si dhe abetaren shqipe dhe tekstet shkollore. Deri në atë kohë rinia shqiptare kishte qenë objekt i propagandës së huaj në shkollat e hapura nga qeveria turke dhe nga kisha greke. Megjithatë, gjatë punës për krijimin e sistemit të tyre shkollor, atdhetarët shqiptarë u ndeshën me tri probleme të mëdha, pengesa nga autoritetet turke dhe greke, me mungesën e të hollave dhe me mungesën e mësuesve të shkolluar.[16]

Mbajtja e Kongresit të Manastirit pati jehonë edhe në shtypin europian. Gazetat francese, italiane, zvicerane etj. , shkruanin se shqiptarët do të mblidheshin në Kongres për qëllime politike, se kishin ndërmend të diskutonin çështjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe se problemet e literaturës, janë vetëm pretekst për t'u realizuar pavarësimi i Shqipërisë. "Kongresi mund të shndërrohej në një bashkim politik dhe se shqiptarët do të japin besën se do të luftojnë me armë në dorë për të mbrojtur të drejtat e tyre kombëtare".[17]

[16] Stefanaq Pollo, *Në gjurmë të historisë shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f. 147.
[17] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2002, f. 435.

PËRFUNDIMI

Në historinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, Kongresi i Manastirit shënon një ngjarje të rëndësishme politike, kulturore, shkencore (gjuhësore) dhe arsimore.

Kongresi Manastirit është kongresi i alfabetit kombëtar të shqipes, që u përpilua dhe u miratua prej të gjithë delegatëve pjesëmarrës, pra alfabeti që përdorim sot ne shqiptarët. Alfabeti kombëtar i sotëm është kurorëzimi i një pune disa shekullore, një proces që zgjati afër katër shekuj dhe që u përfundua në nëntor të vitit 1908 me punën e *Komisionit të Kongresit të Manastirit*.

Deri në këtë datë, në Shqipëri janë përdorur disa alfabete nga intelektualë, shoqëri e klube politike, kulturore, arsimore dhe institucione të ndryshme. Në rrethanat e pushtimit shekullor turk përdoreshin alfabete të ndryshme në shkrimin e shqipes, të cilët ishin krijuar nga lëvrues të gjuhës shqipe, shkrimtarë, gazetarë etj., kështu që shqiptarët u detyruan ta shkruajnë gjuhën e tyre, sipas mundësive e konceptimeve individuale, me alfabete të ndryshme: me shkronja latine, greke, turke-arabe, e më rrallë edhe me shkronja të veçanta.

Për shkak të përdorimit të disa alfabeteve, në shkrimin e shqipes vërehej një anarki e vërtetë: dëmtohej kultura tradicionale, arsimi i njësishëm dhe uniteti kombëtar. Ky problem ishte i vështirë dhe kërkonte zgjidhje. Kur lëvizja jonë për çlirim kombëtar ishte në rritje, kërkesa për një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët u shtrua për zgjidhje urgjente nga rilindësit tanë, sidomos gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, si objektivi numër një i *Rilindjes Kombëtare* për gjuhën, kulturën dhe për pavarësinë kombëtare shqiptare.

Zgjidhja e problemit ishte zvarritur kryesisht për shkaqe objektive. Shkaku i parë që i ka penguar shqiptarët në zgjidhjen e shpejtë të problemit të alfabetit, lidhet me rrethanat politike që ka përjetuar Shqipëria nën pushtimin shekullor turk, gjatë të cilit shqiptarëve u janë mohuar në mënyrë të veçantë të drejtat e elementare. Kjo ka ndodhur për shkak të luftës heroike të popullit tonë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut kundër Perandorisë turke. Për këtë arsye shqiptarët, siç dihet, nën rrethanat e pushtimit të huaj nuk lejoheshin të shkruanin e të lëvronin gjuhën e tyre amtare, shkollat shqipe nuk lejoheshin të hapeshin në një kohë që Shqipëria po mbytej nga shkollat e huaja turke, greke, sllave, etj.

Të njëjtën politikë shkombëtarizuese ndiqnin ndaj Shqipërisë edhe fqinjët tanë. Turqia imponontе alfabetin arabo-turk, Greqia alfabetin grek etj., pra shkaku i parë lidhet me faktorin e jashtëm.

Shkaku i dytë është pasojë e të parit dhe ka të bëjë me faktin se problemet madhore, siç është edhe rasti i përpilimit e miratimit të një alfabeti kombëtar, zgjidhen me marrëveshje dhe punë të organizuar institucionale kombëtare, çka në rrethanat e sipërpërmendura nuk ishte e lehtë të realizoheshin. Shkaku tjetër, që vështirësonte zgjidhjen e problemit të alfabetit të përbashkët për të gjithë shqiptarët ishte thjesht i karakterit shkencor; ai kishte të bënte me sistemin e pasur dhe në disa raste origjinal të tinguj-fonemave të shqipes, për shkrimin e të cilëve kërkoheshin më shumë shkronja sesa kishte latinishtja ose gjuhët e tjera.

Prandaj çështja e alfabetit u zgjidh në prag të Pavarësisë së Shqipërisë, në Kongresin e Manastirit, kur iu hap rruga edhe zgjidhjes së shumë çështjeve të tjera të rëndësishme për popullin shqiptar, siç kanë qenë shpallja e pavarësisë së vendit (1912), si dhe njësimi i gjuhës letrare shqipe në Kongresin e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1972.

Literatura:

1. ***Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit***, *Tiranë, 1972.*
2. *Mahir Domi, (përmbledhje studimesh) te* ***Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit,*** *Tiranë, 1972.*
3. *Tomor Osmani,* ***Udha e shkronjave shqipe****, Shkodër, 1999.*
4. *Ragip Mulaku,* ***Ndihmesa për gjuhës shqipe****, Prishtinë, 2015.*
5. *Isa Bajçinca,* ***Shqipja standarde dhe probleme rreth saj****, Prishtinë, 2016.*
6. *Shukri Rrahimi,* ***Gjurmime Historike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare****, Prishtinë, 1986.*
7. *Grup autorësh,* ***Historia e Popullit Shqiptar II, Prishtinë, 1972.***
8. *P. Bartol,* ***Shqiptarët nga Mesjeta deri në ditët tona****, Instituti i dialogut dhe komunikimit, 1995.*
9. *Rexhep Qosja,* ***Semantikë e ndryshimeve historike letrare****, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009.*
10. *Edwin Jack,* ***Shqiptarët, Kartë e pendë,*** *Tiranë, 1995.*
11. *Strfanaq Pollo,* ***Në gjurmë të historisë shqiptare****, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2003.*
12. *Abdyli, Ramiz: (2010)* ***Kongresi i Dytë i Manastirit****, Studime Albanologjike, 2 Shkup.*
13. *Aleks Buda,* ***Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit****, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë, Tiranë, 1972.*

14. *V. Duka*, ***Historia e Shqipërisë 1912-2000****, Kristalia, Tiranë, 2007.*

15. *Grup Autorësh,* ***Historia e Popullit Shqiptar II,*** *Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2002*